



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2019:230754

Datë: 18.10.2024

Numri i dokumentit: 06322668

C.nr.119/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, Rruga “Lidhja e Pejës”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.G., kundër të paditurit A.S., me vendbanim Vushtri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L. M., avokat me seli në Vushtri, me objekt kontesti rimbursim i dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 03.10.2024, mori dhe me datë 18.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve dhe DETYROHET i padituri A.S., që në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e datës 08.04.2016, t’ia paguaj paditëses shumën prej 1,795.40 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 20.03.2019 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses përtej shumës së gjykuar me dispozitivin I, të këtij aktgjykimi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit për aksidentin e datës 08.04.2018, t’ia rimbursoj paditëses edhe shumën prej 463.60 euro.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 20.03.2019, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurit A.S., me objekt kontesti rimbursim i dëmit.

Pretendimet e palëve

Paditësja përmes padisë dhe gjatë seancave ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e saj në tërësi si e bazuar dhe gjykata ta detyroj të paditurin që si përgjegjës i aksidentit të datës 08.04.2016, ta rimbursoj paditësen për kompensimin material që paditësja i ka bërë të dëmtuarve nga ky aksident E. H. në shumën prej 1,184.00 euro, Q. H., në shumën prej 320.00 euro dhe Kryqit të Kuq në Vushtrri, në shumën prej 755.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 2,259.00 euro. Ka shtuar se pas aksidentit për faktin se i padituri e ka shkaktuar aksidentin pa mbulesë siguruese, konkretisht me afat të skaduar të sigurimit dhe për këtë arsye duke u bazuar në nenin 18 par 4, të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (LSDA), përgjegjësia për dëmin bie mbi të paditurin që ka vozitur pa mbulesë siguruese. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se gjykata duhet ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sepse nga ekspertiza e komunikacionit është konstatuar në mënyrë të qartë se përgjegjës për shkaktimin e aksidentit është vetëm i padituri.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

I padituri përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se nuk është kontestuese baza juridike sepse i padituri ka shkaktuar vet aksident por kontestuese është lartësia e kërkesëpadiisë së paditëses sepse sipas tyre paditësja ka kompensuar me shuma të papranueshme të dëmtuarit, pa bërë një vlerësim real për dëmet e automjeteve të tyre. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i të paditurit ka deklaruar se shuma e kërkuar nga paditësja me kërkesëpadi nuk është reale, kurse vlera e dëmit i përcaktuar nga eksperti i makinerisë në këtë proces gjyqësor është i arsyeshëm.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova:

Raporti i policisë me numër 2016-BR-234, i datës 08.04.2016, Kërkesa për kompensim të dëmit e datës 20.04.2016, për Q. H., për dëmin material, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 17.05.2016, në mes të paditëses dhe Q. H., Urdhërtransferi (pagesa), për kompensimin e të dëmtuarit Q. H., në shumë prej 320 euro, Kërkesa për kompensim të dëmit e datës 19.04.2016, për E. H., për dëmin material, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 20.06.2016, në mes të paditëses dhe E. H., Urdhërtransferi (pagesa), i datës 17.08.2016, për kompensimin e E. H. në shumë prej 1,184 euro, Kërkesa për kompensim të dëmit e datës 25.04.2016, për H. O. (Kryqi i Kuq), Ujdia jashtëgjyqësore e datës 27.07.2016, në mes të paditëses Kryqit të Kuq, Urdhërtransferi (pagesa), i datës 02.09.2016, për kompensimin e H. O. i cili ka qenë i autorizuar i Kryqit të Kuq që të kompensohet nga BKS (Kryqit të Kuq), në shumë prej 755 euro, për dëmin material, Ekspertiza e komunikacionit e datës 31.07.2024, e punuar nga eksperti B. S. dhe Ekspertiza e makinerisë së datës 12.09.2024, punuar nga eksperti S. B..

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se me datë 08.04.2016, rreth orës 05:00 ishte shkaktuar aksidenti i komunikacionit ku ishte përfshirë automjeti i drejtuar nga i padituri dhe tri veturave të të dëmtuarve, të cilat ishin të parkuara në rrugë dhe se në ditën e shkaktimit të aksidentit, i padituri nuk ka pasur mbulesë siguroese. Kontestuese po ashtu nuk ishte edhe fakti se të dëmtuarit janë kompensuar për dëmet e pësuar në këtë aksident, në shumën e përgjithshme prej 2,259.00 euro. (Për këtë arsye nuk do të elaborohen secila nga provat e administruara që kanë të bëjnë me raportin në mes të dëmtuarve dhe paditëses)

Nga i autorizuari i të paditurit, avokati L. M., në seancën e shqyrtimit kryesor po ashtu nuk ishte kontestues as përgjegjësia e të paditurit në shkaktimin e vet aksidentit, ndërsa avokati D. I., që kishte autorizim bartës nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit, në fjalën përfundimtare ka theksuar se përgjegjësia për shkaktimin e aksidentit duhet të ndahet 50% për të dëmtuarit dhe 50% për të paditurin.

Kontestuese në mes palëve ishte lartësia e kërkesës së paditëses për rimbursimin e dëmit, konkretisht vlerësimi i paditëses për lartësinë e dëmeve materiale të të dëmtuarve, Q. H., E. H. dhe Kryqi i Kuq-Vushtrri.

Nga Raporti policor i aksidentit të trafikut me numër 2016-BR-234, i datës 08.04.2016, së bashku me skicën e aksidentit, është konstatuar se dyshohet se deri te aksidenti ka ardhur derisa automjeti “A” (i padituri), derisa ishte duke lëvizur në rrugën “I. Q.”, në Vushtrri, duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes e ka humbur kontrollin mbi automjetin e vet dhe del në shiritin e djathtë të rrugës, ashtu që e godet automjetin “B”, (pronë e E. H.) i cili ishte i parkuar, ashtu që nga goditja e fortë, automjeti “B”, lëvizë para, duke e goditur automjetin “C”, (pronë e Kryqit të Kuq) ndërsa automjeti “C”, po ashtu kishte lëvizuar para dhe e ka goditur automjetin “D” (pronë e Q. H.)

Nga Urdhërtransferi (pagesa), për kompensimin e të dëmtuarit Q. H., në shumë prej 320 euro, nga Urdhërtransferi (pagesa), i datës 17.08.2016, për kompensimin e E. Haliti në shumë prej 1,184 euro, dhe nga Urdhërtransferi (pagesa), i datës 02.09.2016, për kompensimin e Kryqit të Kuq, tek i autorizuari i tyre H. O., në shumë prej 755 euro, gjykata ka vërtetuar se paditësja i’ a ka kompensuar të dëmtuarve në shumën e përgjithshme prej 2,259.00 euro.

Nga Ekspertiza e komunikacionit e datës 31.07.2024, e punuar nga eksperti i komunikacionit B. S., është theksuar se bazuar në raportin e aksidentit të Policisë së Kosovës, skicës së vendit të ngjarjes dhe të dhënave mbi rrugën, është arritur në konstatimin se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të ngasësit të automjetit “A” (të paditurit), i cili nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes sipas kushteve dhe rrethanave të rrugës, ashtu që në lëvizje rrugën dy kohore me dy shirita në një drejtim, dhe pasi në shiritin e skajshëm në drejtimin e Vushtrrisë dhe ngasësi i automjetit “A” nga mos pakujdesia dhe vëmendja jo e duhur, e humb kontrollin mbi automjetin e tij, del në shiritin e djathtë të rrugës dhe me pjesën e përparme e godet në pjesën mbrapa automjetin “B”, i cili nga godita e fortë, lëvizë para tre metra dhe me pjesën e përparme e godet automjetin “C”, e cila po ashtu ishte e parkuar dhe nga godita lëvizë para 2.5 metra dhe me pjesën e përparme e godet automjetin “D”.

Nga Ekspertiza e makinerisë e datës 12.09.2024, e punuar nga eksperti i makinerisë S. B., është konstatuar se vetura e të dëmtuarit E. H., “Fiat” 182-Bravo, nga aksidenti që është shkaktuar, ka pasur dëm në pjesën e përparme dhe të pasme ballore, çka ka ndikuar që të konsiderohet si “dëm

i madh material”. Ka shtuar se në kohën e aksidentit (viti 2016), sipas tregut vendor ka pasur një mesatare të çmimit prej 1,136.00 euro dhe nga dëmet që i ka pësuar në aksidentin e shkaktuar nga i padituri, ky automjet ka pasur dëm total 880.40 euro, ndërsa pjesa tjetër prej 22.5%, janë vlerësuar si mbetje dhe eksperti në seancës e datës 03.10.2024, ka deklaruar se këto mbetja të cilat janë vlerësuar në shumën prej 255.60 euro, mund të shitën në hekurishte, që është edhe vlerë pothuajse e barabartë edhe me shitjen e mjetit të dëmtuar dhe në këtë mënyrë dëmi real i këtij automjeti është vlerësuar në shumën prej 880.40 euro. Për këtë automjet eksperti në seancë deklaroi po ashtu se nga krahasimi për çmimin e tregut në kohën e aksidentit, rezulton se më lirë ka kushtuar ky automjet me çmimin mestar prej 1,136.00 euro sesa i njëjti të riparohej.

Nga ekspertiza e makinerisë për automjetin e dëmtuar të Kryqit të Kuq “Toyota Landcruiser” është konstatuar se automjeti si pasoj e aksidentit është dëmtuar në pjesën e përparme dhe në pjesën e pasme ballore, ashtu që për riparimin e këtij automjeti është konstatuar se disa nga pjesët e dëmtuara duhet që të ndërrohen e disa të tjera të riparohen, kurse çmimi për orët e punës është bazuar nga çmimet e serviseve për riparimin e automjeteve në lokacionin ku ka ndodhur aksidenti. Eksperti ka vlerësuar se për këtë automjet, është dashur që të ndërrohen pjesët “mbrojtësi i pasëm” me çmimin prej 250.00 euro, “drita e pasme” me çmim prej 100.00 euro dhe “shkalla e poshtme”, me çmim prej 90.00 euro, kurse pjesët e tjera (mbrojtësi i parë, krahu i pasëm, riparime mekanike, hidraulike, elektrike, regllazha etj), kanë pasur nevojë vetëm të ndërrohen. Po ashtu materiali për ngjyrosje është vlerësuar me 60.00 euro dhe materiali plotësues në shumën prej 10.00 euro, ndërsa përpos shpenzimeve për ndërrim, riparim dhe ngjyrosje, eksperti ka përcaktuar edhe çmimin për orët e punës, ashtu që ka përcaktuar që për riparimin e automjetit janë dashur gjashtë (6) orë pune, me 12 euro për orë pune për ndërrim/riparim, e po ashtu edhe për ngjyrosje janë dashur gjashtë (6) orë pune, me 12 euro për orë pune për ngjyrosje, ashtu që dëmi i kësaj veture është vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 662.00 euro.

Sipas ekspertizës së makinerisë për automjetin e dëmtuar të Q. H. “Renault Espace” është konstatuar se automjeti si pasoj e aksidentit është dëmtuar në pjesën e pasme ballore, ashtu që edhe për riparimin e këtij automjeti është konstatuar se disa nga pjesët e dëmtuara duhet që të ndërrohen e disa të tjera të riparohen, dhe se çmimi për orët e punës është bazuar nga çmimet e serviseve për riparimin e automjeteve në lokacionin ku ka ndodhur aksidenti. Eksperti ka vlerësuar se për këtë automjet, është dashur që të ndërrohen pjesët “mbrojtësi i pasëm” me çmimin prej 60.00 euro dhe “kapaku i bagazhit” me çmim prej 50.00 euro, kurse pjesët e tjera (llamarina lidhëse e pasme, riparime mekanike, hidraulike, elektrike, regllazha etj), kanë pasur

nevojë vetëm të ndërrohen. Po ashtu materiali për ngjyrosje është vlerësuar me 40.00 euro dhe materiali plotësues në shumën prej 10.00 euro, ndërsa përpos shpenzimeve për ndërrim, riparim dhe ngjyrosje, eksperti ka përcaktuar edhe çmimin për orët e punës, ashtu që ka përcaktuar që për riparimin e automjetit janë dashur katër (4) orë pune, me 10 euro për orë pune për ndërrim/riparim, e po ashtu edhe për ngjyrosje janë dashur katër (4) orë pune, me 10 euro për orë pune për ngjyrosje, ashtu që dëmi i kësaj veture është vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 253.00 euro

Lidhur me ndryshimet në vlerësimin e orëve të punës në mes automjetit “Toyota Landcruisser” dhe “Renault Espace”, eksperti në seancë ka sqaruar se automjeti “Toyota Landcruisser” i Kryqit të Kuq, është i paraparë për terrene të vështira dhe ky automjet dallon edhe për nga materiali, me të cilin material është edhe më vështirë të punohet dhe se për këtë arsye edhe ka dallim në mes të çmimit për orë pune.

Me nenin 136,1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD) është përcaktuar që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 137 të këtij ligji është paraparë që *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, kurse me nenin 960 të po këtij ligji thuhet se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*

Po ashtu me nenin 18 par 4 i Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet që *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*, kurse me par 4, të këtij neni thuhet se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

Përpos se në seancën kryesore përgjegjësia e të paditurit për shkaktimin e aksidentit nuk është kontestuar as nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit, faktin se i padituri është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit të datës 08.04.2016, në të cilin aksident i janë shkaktuar dëme materiale të dëmtuarve E.H., Q. H. dhe Kryqit të Kuq në Vushtrri, gjykata e ka vërtetuar nga Raporti i

aksidentit i Policisë së Kosovës me nr. 2016-BR-234, i datës 08.04.2016, së bashku me skicën e vendit të ngjarjes, e posaçërisht edhe nga ekspertiza e komunikacionit e datës 31.07.2024, e punuar nga eksperti i komunikacionit B. S., e cila ekspertizë për gjykatën është bindëse dhe profesionale, që është punuar duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës dhe ka përshkruar në detaje lëshimet e të paditurit në shkaktimin e aksidentit të datës 08.04.2016, duke arritur në konstatimin se aksidenti ka ndodhur për shkak të lëshimeve të të paditurit, i cili duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës, derisa ishte duke lëvizur në rrugën dy kohore me dy shirita në një drejtim, e ka humbur humbur kontrollin mbi automjetin e tij, del në shiritin e djathtë të rrugës dhe me pjesën e përparme e godet në pjesën mbrapa automjetin “B”, i cili nga godita e fortë, lëvizë para tre metra dhe me pjesën e përparme e godet automjetin “C”, e cila po ashtu ishte e parkuar dhe nga godita lëvizë para 2.5 metra dhe me pjesën e përparme e godet automjetin “D”.

Kurse deklarimin e përfaqësuesit me autorizim bartës, të dhënë në fjalën përfundimtare se përgjegjësia duhet të ndahet 50% për të paditurin dhe 50% për të dëmtuarit për shkak se të njëjtit nuk i kanë pasur të ndezur katër treguesit dhe se kanë qenë në vend ku ndalohet parkimi është tërësisht i pabazuar dhe i pambështetur në asnjë provë.

Vendimi lidhur me lartësinë e rimbursimit

Pasi sipas nenit 18 par 1 të LSDA-së, paditësja duhet t'i kompensoj të dëmtuarit për dëmet që i shkaktohen nga mjetet motorrike të pasiguruara, nga Urdhërtransferi, për kompensimin e të dëmtuarit Q. H., në shumë prej 320 euro, nga Urdhërtransferi (pagesa), i datës 17.08.2016, për kompensimin e E. H. në shumë prej 1,184 euro, dhe nga Urdhërtransferi (pagesa), i datës 02.09.2016, për kompensimin e Kryqit të Kuq, tek i autorizuari i tyre H.O., në shumë prej 755 euro, gjykata ka vërtetuar se paditësja në emër të dëmit material i'a ka kompensuar të dëmtuarve në shumën e përgjithshme prej 2,259.00 euro.

Mirëpo, nga nxjerrja e ekspertizës së makinerisë në këtë proces gjyqësor, e cila ka konstatuar se dëmi material i automjetit të dëmtuarit E.H., vlerësohet në shumën prej 880.40 euro, dëmi material i automjetit të të dëmtuarit Q. H. në shumën prej 253.00 euro dhe dëmi i automjetit të Kryqit të Kuq në Vushtri, është vlerësuar në shumën prej 662.00 euro, gjykata ka vërtetuar se dëmi real dhe i përgjithshëm material i tre të dëmtuarve, është në shumën prej 1,795.40 euro.

Duhet theksuar se ndaj ekspertizës së makinerisë nuk kishte kundërshtime e as vërejtje as pala paditëse e as i padituri, kurse gjykata të njëjtën ekspertizë e ka vlerësuar si bindëse dhe profesionale sepse eksperti i makinerisë për secilën nga automjetet e të dëmtuarve ka dhënë një përshkrim gjithëpërfshirës për metodologjinë e përdorur në çmimin e tregut, vlerësimin e dëmeve, përcaktimin e çmimit të pajisjeve për ndërrim dhe riparim e po ashtu edhe orët e punës për kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme dhe i njëjti i ka ofruar palëve dhe gjykatës të gjitha sqarimet e nevojshme në seancë gjyqësore për mënyrën e vlerësimit që ai ka bërë në ekspertizë.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në ekspertizën e makinerisë, e në ndërlidhje me nenin 18 par 4 të LSDA-së dhe në nenin 960 par 1 të LMD-së, ka marrë vendim si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi, pasi në këtë procedurë gjyqësore është vërtetuar se i padituri është përgjegjës për aksidentin e shkaktuar dhe se aksidentin e ka shkaktuar me automjetin i cili nuk ka pasur mbulesë siguroese, ashtu që ka detyruar të paditurin që paditëses t'ia rimbursoj shumën prej 1,795.40 euro, si kompensim i drejtë dhe real për dëmet materiale që kanë pësuar të dëmtuarit E. H., Q. H. dhe Kryqit të Kuq në Vushtri.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditëses i'a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 20.03.2019, si dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata me dispozitivin II, të këtij aktgjykimi e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses që në emër të kompensimit të dëmit për të dëmtuarit, të rimburohet edhe në shumën prej 463.60 euro sepse ashtu siç është theksuar më lartë, vlerësimi real i dëmit material për të dëmtuarit, i bazuar në ekspertizën e makinerisë është në shumën prej 1,795.40 euro, e të cilin dëm i padituri detyrohet t'ia paguaj paditëses në emër të rimbursimit. Gjykata e ka të njohur faktin se paditësja sipas vlerësimit të tyre të brendshëm, të dëmtuarit i ka kompensuar në shumën prej 2,259.00 euro në emër të kompensimit të dëmit, që është 463.60 euro më shumë sesa vlerësimi i ekspertizës së makinerisë (1,795.40 euro), mirëpo pavarësisht vlerësimit të dëmit dhe shumës së kompensimit që paditësja i ka bërë të dëmtuarve, i padituri si përgjegjës i aksidentit, nuk mund të detyrohet të paguaj në emër të rimbursimit të dëmit, përtej dëmit real të vërtetuar në këtë proces gjyqësor me ekspertizë të makinerisë. Duhet theksuar po ashtu se paditësja nuk ka ofruar prova të tjera që do ta bindnin gjykatën se vlerësimi real i dëmeve të të dëmtuarve është në shumën prej 2,259.00 euro e jo siç është konstatuar me ekspertizën e makinerisë, në vlerën prej 1,795.40 euro, andaj

përderisa gjykata ka vlerësuar se kjo ekspertizë është bindëse dhe profesionale, me dispozitivin I, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses për rimbursimin e dëmit në këtë shumë të vlerësuar kurse me dispozitivin II, e ka refuzuar rimbursimin në vlerën prej 463.60 euro, për shkak se kërkesa për rimbursimin e kësaj shume, është vërtetuar se është e pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale duke u bazuar në nenin 449 e 450 të LPK-së e po ashtu e po ashtu nenit 463.1, të LPK-së sipas të cilit përcaktohet që *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”* dhe paragrafit 2 të këtij neni sipas të cilit thuhet se *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*. Kjo ngase pavarësisht se përfaqësuesja e paditëses në fjalën përfundimtare i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, e njëjta nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës ashtu siç kërkohen me dispozitat e lartcekura të LPK-së dhe për këtë arsye gjykata nuk mund të i’a njohë shpenzimet procedurale paditëses, kurse i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:230754, C.nr.119/2019, me datë 18.10.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.